



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **62**

Prishtinë, më 12.1.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Zulfi Merxha, Hestet Cakolli, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Myrvete Pantina, Ali Lajçi.

Mungoi : Dragiša Mirić, Zef morina, Selvie Halimi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtar të MMPH, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku .

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 21.12.2009,
2. Projektligji për financimin e programeve të veçanta të banimit,
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës** për të cilat nuk kishte vërejtje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 21.12.2009

Naser Rugova-kryetar konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 21.12.2009.

2. Shqyrtimi i projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit

Kryetari Naser Rugova në fillim falënderoi grupin punues bashkë me zyrtarë të MMPH për punën e bërë gjatë shqyrtimit të këtij projektligji. Pasi që propozoi të shqyrtohen vërejtjet e GP, komisioni miratoi si vijon :

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e projektligjit **“Buxheti i Konsoliduar i Kosovës”** zëvendësohet me **“Buxheti i Republikës së Kosovës”**.

Amendamenti 2

Neni 2,

Tek përkufizimi “**Kontratë e qerasë**”, fjala “**është**” fshihet.

Përkufizimi “**Autoriteti menaxhues**” fshihet.

Amendamenti 3

Neni 3, riformulohet titulli :

“Programet e veçanta të banimit”

Riformulohet Paragrafi 1:

“Sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qera, ku përfshihen :”.

Riformulohet Paragrafi 1. pika 1.3.

“Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim”.

Amendamenti 4

Neni 4, riformulohet Paragrafi 1:

“Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta për banim përfshijnë familjet që:”

Riformulohet Paragrafi 2 :

“Administrimi i kërkesave për programet e veçanta për banim bëhet nga organi kompetent komunal”.

Amendamenti 5

Neni 5, paragrafi 1, fjala në reshtin e 3 “**neni 5**” zëvendësohet me fjalën “**neni 4**”.

Amendamenti 6

Neni 6, paragrafi 1, pika 1.1, fjalët “**i cili nuk duhet të jete nën vlerën 105 Euro(45m²)**”, fshihen.

Paragrafi 1, pika 1.2, fjalët “**i cili nuk duhet të kaloje vleren 300 Euro(60m²)**”, fshihen.

Paragrafi 1, pika 1.3, formula “**Ve = 350 Euro/m²**”, fshihet.

Amendamenti 7

Pas **Nenit 7** shtohet :

Neni i ri

“Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave

1.Banesat me qera nga programet e veçanta të banimit administrohen nga Organi Kompetent Komunal.

2.Mirëmbajtja e banesave me qera nga programet e veçanta të banimit kryhet nëpërmjet kontraktimit të personave juridik të licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.”

Amendamenti 8

Neni 8, shtohet në fund paragrafi :

“5. Kur banesat e programeve të veçanta financohen nga burime tjera të përcaktuara me pikën 1.3 të Nenit 13 dhe me pikën 1.3 të Nenit 17 vlera e qerasë e shprehur me Euro/m², përcaktohet për çdo rast specifik në bashkëpunim në mes subjekteve që financojnë dhe komunës ku zbatohet projekti dhe miratohet me vendim të Kuvendit Komunal.”

Amendamenti 9

Neni 11

Ne titull fshihet fjala “**dhe**”,

Paragrafi 3, fjalët në fillim “**Kushtet dhe kriteret**” zëvendësohen me fjalën “**Procedurat**”.

Paragrafi 4, fjalia e dyte e paragrafit riformulohet :

“Pas verifikimit të gjendjes dhe vlerësimit të familjeve përfituese lëshohet vendimi në afat prej 30 ditësh kalendarikë.”

Amendamenti 10

Pas **Nenit 11** shtohet :

Neni i Ri

“Shkëputja e kontratës së qerasë

1. Organi kompetent komunal, shkëput kontratën për qiranë në rastet kur:

1.1. qiramarrësi ka bërë deklaram të rrejshëm për të ardhurat;

1.2. qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk ka njoftuar organin kompetent komunal;

1.3. qiramarrësi ia lëshon banesën me qera palës së tretë.

2. Pas shkëputjes së kontratës, qiramarrësi ftohet ta lirojë vullnetarisht banesën, në të kundërtën organi kompetent kërkon largimin e dhunshëm nga banesa.”

Amendamenti 11

Neni 12, paragrafi 2, fjalët në fund “**konform Ligjit për Procedurën Administrative**” fshihen.

Amendamenti 12

Neni 13, shtohet një pikë tek paragrafi 1 :

“1.3. banesa sigurohet me financim nga organizatat joprofitabile”.

Amendamenti 13

Neni 17, paragrafi 1.1 riformulohet :

“1.1. 0.3 % e Buxhetit të Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;”

Amendamenti 14

Neni 19, paragrafi 1 riformulohet :

“1. Në bazë të programeve tre vjeçare të Komunave bëhet planifikimi i buxhetit për programet e veçanta për banim ku parashihet financimi i ndërtimeve të reja për banim, subvencionimi i qirasë dhe bonuset e banimit për komunat e ndryshme të Kosovës.”

Paragrafi 2 në fillim riformulohet :

“2. Për planifikimin e buxhetit për programet e veçanta për banimit merren parasysh këta faktorë:”

Amendamenti 15

Neni 20, titulli “Implementimi” zevendesohet me “Zbatimi”.

Amendamenti 16

Neni 23, paragrafi 1.7, fjalet “ose autoriteteve të menaxhimit të licencuar;” te fshihen.

Amendamenti 17

Pas nenit 24 shtohen dy Nene te Reja :

Neni i ri Mbikëqyrja

Mbikëqyrja e zbatimit te dispozitave të këtij Ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji do të bëhet nga autoriteti përgjegjës për çështjet e banimit ne kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Neni i ri Inspektimi

1. Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e këtij Ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji do të bëhet nga Inspektoratit Komunal përmes inspektorëve të autorizuar të urbanizmit.

2. Inspektorët nga paragrafit (1) i këtij neni, gjatë kryerjes se inspektimit do të vërtetojnë shfrytëzimin e rregullt te banesave në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore respektivisht normat e percaktuara per objektet e banimit.

Amendamenti 18

Neni 25, riformulohet :

1. Në kuptim të këtij Ligji, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe shqiptohen dënime me gjobë:

1.1. Për shkelje të paragrafit 1.1, të nenit 12, qiramarrësi detyrohet të largohet nga banesa me qira dhe të kthej shumën e përfituar nga programet e veçanta për banim.

1.2. Për shkelje të paragrafit 1.2, të nenit 12, qiramarrësi gjobitet me të holla në shumë prej 200 deri në 400 Euro;

1.3 Për shkelje të paragrafit 1.3, të nenit 12, qiramarrësi gjobitet me të holla në shumë prej 400 deri në 600 Euro;

2. Falsifikimi i bonusit të banimit dënohet sipas Kodit Penal në fuqi .

3. Shqiptimi i kundërvajtjeve bëhet nga organi kompetent komunal.

4. Kundër vendimit të organit kompetent komunal mund te behet ankese brenda 30 ditësh Kuvendit Komunal i cili duhet të marr vendim brenda 30 ditësh.

5. Kundër vendimit nga paragrafi 4 i këtij neni, pala e pakënaqur mund të bëjë ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Amendamenti 19

Neni 26, riformulohet :

1. Banesat qe janë ndërtuar para marsit 1999 për strehimin e refugjateve nga organizatat ndërkombëtare humanitare kalojnë ne pronësi te Komunave ku ato banesa ndodhen. Familjet qe vendosen ne këto banesa përzgjidhen sipas kriterëve te këtij ligji.

2. Banesat te cilat janë ndërtuar nga institucionet shtetërore pas vitit 1999 me fonde publike trajtohen sipas dispozitave te këtij ligji.

3. Ministria në afat deri gjashtë muajsh, pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, nxjerr Udhëzime Administrative për zbatimin e këtij Ligji .

Amendamenti 20

Neni 27, riformulohet :

Ky ligj shfuqizon çdo akt ligjor që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Naim Maloku kërkoi nga raportuesi i projektligjit që të potencoi gjatë seancës plenare me rastin e shqyrtimit, që ministria (Qeveria) mos ti dërgoi projektligjet me termin e vjetruar tanimë Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por me termin që tani përdoret Buxheti i Republikës së Kosovës (Amendamenti 1).

Me kërkesën e **Naim Malokut** komisioni kërkoi sqarim juridik : pasi që paragrafi i shtuar me Amendamentin 8 apostrofon dy nene pasuese të projektligjit, a është në rregull ky intervenim në këtë mënyrë.

Për paragrafin 2 (Amendamenti 10) **Naim Maloku** pyeti a ka nevojë të ceket afati i lirimit të banesës. Anëtarja e GP **Elheme Hetemi** me mbështetjen e zyrtarëve të MMPH tha se kjo çështje i takon procedurës përmbarese, ndaj afati është çështje interne e atyre organeve.

Kryetari Naser Rugova në fund kërkoi nga stafi të sqarohet përmes zyrtarëve të MMPH a duhet të figuroi fjala “të licencuar” te paragrafi 2 i nenit të shtuar pas nenit 7, si dhe tek neni 25 paragrafi 5 a duhet të ceket organi ku shqyrtohet ankesa e parashtruar.

3. Të ndryshme

Në këtë pikë kryetari **Naser Rugova** propozoi shqyrtimin e raportit të punës njëvjeçare dhe kërkesën e komisionit për këshilltarë profesional dhe ligjorë.

1. Raporti i punës së komisionit për vitin 2009, pasi që është lexuar nga anëtarët e komisionit, u **miratua njëzëri nga Komisioni**.

2. Lidhur me **këshilltarët** për këtë komision **kryetari Naser Rugova** konstatoi se gati është e pamundur që të vazhdoi komisioni më tutje punën nëse nuk sigurohen këshilltarët profesional edhe ligjor për këtë komision në të ardhmen, ndaj kërkoi nga komisioni të arrihet pajtimi në parim që të bëhen kërkesat e duhura në adresat e caktuara për këshilltarë të duhur. Ai tha se ka biseduar me zyrtarë të USAID-it për dy ekspertë dhe një nga Komisionit Evropian për ndihëm të nevojshëm komisionit me këshilltarë për dy lëmi shumë të rëndësishëm në fushën e këtij komisioni Bujqësinë dhe Mjedisin, dhe shprehu habinë pse nuk është kërkuar deri tani kjo nga kryetari i deritashëm i komisionit. Është absurde, vazhdoi ai, që niveli siç është ky komision, të shqyrtoi gjëra shumë të imta siç është lekturimi i projektligjeve apo çështje tjera teknike, ndaj me ngulmë duhet të kërkohet në kryesi që secili organ i Kuvendit të kryej atë çka i takon. Paraprakisht duhet të pajiset Kuvendi me strategjinë dhe kalendarin legjislativ për vitin 2010, pastaj të caktohen këshilltarët me detyrat që i takojnë atyre, ngase rastësisht ky komision e ka vetëm një deputete që i takon lëmisë së agrikulturës. Përfundimisht muaji shkurt duhet të jetë muaji kur do të fillojnë këto lëvizje për krijimin e kushteve elementare për punën e këtij komisioni.

Elheme Hetemi tha se kjo kërkesë ka qenë edhe më herët e parashtruar në këtë komision, ndaj plotësisht arsyetoi përmbushjen e zbrastirës në punën e komisionit me këshilltarë profesional gjithsesi, por edhe me këshilltarë ligjorë ngase gjatë seancave plenare po shihet mungesa e tyre në punën e komisioneve ngase po bëhen vërejtje të shumta. Për shkak të mundësive ekzistuese financiare të Kuvendit, ajo mendon se më e realizueshme do të ishte pagesa e mëditjeve për këta këshilltarë AD HOC sa herë që të angazhohen në komision nga fondi i komisionit. Ajo shtoi se është e pamundur të vazhdohet kjo mënyrë e punës së komisioneve parlamentare ku shumica e deputetëve detyrohen ti gjuajnë shkresat që i mbledhin në Kuvend ngase iu mbushet shtëpia me dokumente.

Ali Lajçi gjithashtu arsyetoi këtë kërkesë dhe apeloj për shfrytëzimin e mundësisë së tillë, ndërsa **Naim Maloku** potencoi caktimin e këshilltarit për çështje të sigurisë nga UNDP ndaj kërkoi një gjë të tillë edhe për këtë komision pasi të arrijë agjenda legjislative për vitin vijues.

Berat Luzha gjithashtu tha se komisioni këto gjëra i ka kërkuar më herët por kryesia nuk ka qenë serioze, ndaj propozoi të shkohet në njërën nga parlamentet e rajonit për të përfituar përvojën e tyre në këtë drejtim dhe kjo çështje të mbetet punë për Kuvendin (caktimi i këshilltarëve për komisione). **Elheme Hetemi** shtoi se nuk ka nevojë ndoshta për këtë

kërkesë të Beratit ngase momentalisht mund të realizohet kjo kërkesë përmes pagesës së këshilltarëve me mëditje.

Myrvete Pantina kategorikisht arsyetoi diskutuesit e deritanishëm ngase kjo nevojë është e padiskutueshme. Ajo tha se në komisionin për buxhet shpeshherë dëgjohej fjala “Kuvendi ska mjete” kurse në anën tjetër asnjë komision nuk e shfrytëzon buxhetin që e ka në dispozicion, ndaj apeloj në këtë drejtim që mos të bëhen kësi lloj ndërhyrjesh të pakuptimta.

Naim Maloku sugjeroi një takim me OJQ-të ekzistuese për mbledhjen e radhës, paraprakisht duke siguruar listën e OJQ-ve dhe diskutimin se çka kishte me bisedua komisioni me përfaqësues të tillë (mjedisore veçantë, bujqësore veçantë).

Përfaqësuesja e UNDP kërkoi fjalën për të njoftuar komisionin se pikërisht gjatë këtij viti fillon me projektin e mbështetjes së komisioneve parlamentare, pasi që një gjë të tillë ka bërë në komisionin për siguri. Propozoi kontakte të vazhdueshme lidhur me këtë çështje ndërsa kryetari falënderoi.

Komisioni nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

1. Komisioni parlamentar për Bujqësi dhe Mjedis miraton në parim kërkesën për këshilltarë profesional dhe ligjor të komisionit duke adresuar këtë çështje institucioneve që mund të kontribuojnë në këtë drejtim siç janë USAID, UNDP, Komisioni Evropian, SIDA etj, ndërsa në një mbledhje të radhës komisioni do të vendos konkretisht për këta këshilltarë.

2. Lidhur me këtë kërkesë të komisionit për këshilltarë do të shfrytëzohet fondi financiar i komisionit, nëse nuk arrihet ndonjë mënyrë tjetër e përmbushjes së kërkesës së tillë të komisionit.

3. Mbledhja e radhës së komisionit do të mbahet pas dy javësh, kur shpresohet se do të mbërrijë strategjia legislative dhe do të përgatitet lista e OJQ-ve për fushën e Mjedisit dhe Bujqësisë.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,10. Mbledhja e radhës do të mbahet më 26.1.2010.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova